**VENDIM**
**Nr. 458, datë 19.6.2026**

# PËR SHPALLJEN E DISA ZONAVE ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E EKONOMISË MALORE NË BASHKINË DEVOLL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2025, "Për paketën e maleve", me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen "Zonë me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore" në territorin e Bashkisë Devoll të zonave, si më poshtë vijon:

a) Zona nr. 1, fshatrat: Miras, Vidohovë, Çetë, Qytezë, Sinicë, Arrëz, Nikolicë, Koshnicë, Sul, Ziçisht, Gjyres, Çipan, Përparimaj, Grapsh, Hoçisht, Grace, Baban, Stropan, Eçmenik, Bradvicë, Cangonj, Pilur, Bickë dhe Vranisht, pjesë të njësive administrative: Miras, Hoçisht dhe Progër, Bashkia Devoll, qarku Korçë, me sipërfaqe 15046 (pesëmbëdhjetë mijë e dyzet e gjashtë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH;

b) Zona nr. 2, fshatrat: Shyec, Rakickë, Buzliqen dhe Tren, pjesë të njësive administrative Progër dhe Qendër Bilisht, Bashkia Devoll, qarku Korçë, me sipërfaqe 2297 (dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) ha, sipas hartës në sistemin KRGJSH.

2. Shtrirja, kufijtë dhe pikat e hyrjes e të daljes së këtyre zonave përcaktohen në hartën treguese sipas sistemit KRGJSH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Llojet e aktiviteteve, që do të zhvillohen në këtë zonë, janë:

a) të zhvillimit ekonomik;

b) të zhvillimit industrial;

c) të zhvillimit turistik.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Devoll për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**




| Zona 1<br>Njësia Administrative Miras, Hoçisht dhe Progër | | |
|---|---|---|
| **Nr** | **Koordinata X** | **Koordinata Y** |
| 1 | 576797.32 | 4507305.67 |
| 2 | 577245.32 | 4507137.67 |
| 3 | 578071.32 | 4505968.67 |
| 4 | 577147.32 | 4504519.67 |
| 5 | 577903.32 | 4503651.67 |
| 6 | 577511.32 | 4501607.67 |
| 7 | 578183.32 | 4500277.67 |
| 8 | 578703.51 | 4490192.23 |
| 9 | 577800.63 | 4487506.06 |
| 10 | 581600.85 | 4486465.39 |
| 11 | 581495.85 | 4484512.39 |
| 12 | 579409.85 | 4482265.39 |
| 13 | 574684.66 | 4483583.66 |
| 14 | 571221.1 | 4483380.87 |
| 15 | 567594.54 | 4478713.27 |
| 16 | 567902.54 | 4486357.27 |
| 17 | 572372.17 | 4486279.49 |
| 18 | 573842.17 | 4504605.49 |
| 19 | 575746.17 | 4505123.49 |
| 20 | 576250.17 | 4507055.49 |
| 21 | 576797.32 | 4507305.67 |




| Zona 2<br>Njësia Administrative Progër dhe Qendër Bilisht | | |
|---|---|---|
| **Nr** | **Koordinata X** | **Koordinata Y** |
| **1** | 584602.31 | 4503078.03 |
| **2** | 582466.07 | 4504393.37 |
| **3** | 583297.41 | 4506189.43 |
| **4** | 579550.17 | 4511301.93 |
| **5** | 582241.37 | 4512661.39 |
| **6** | 583779.24 | 4508184.49 |
| **7** | 584976.24 | 4508002.49 |
| **8** | 586422.31 | 4504723.03 |
| **9** | 585106.31 | 4504345.03 |
| **10** | 584602.31 | 4503078.03 |